

PJESËMARRJA E STUDIUESVE TË INSTITUTIT
TË HISTORISË-TIRANË NË VEPRIMTARI TË NDRYSHME

PJETËR BUDI NË 440-VJETORIN E LINDJES
Tiranë, 4 dhjetor 2006

Në Muzeun Historik Kombëtar më 4.12.2006, u organizua një sesioni shkencor kushtuar Pjetër Budit me rastin e 440-vjetorit të lindjes së tij. Në këtë veprimtari shkencore ku morën pjesë historianë, gjuhëtarë, specialistë të artit e të kulturës si dhe të ftuar nga institucionet shkencore të vendit referuan akademik Rexhep Ismajli, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademik Shaban Demiraj, prof. dr. Kolec Topalli, prof. dr. Floresha Dado, prof. dr. Seit Mancaku, prof. dr. Valter Shtylla, Zimo Krutaj si dhe studiuesi i njohur i Budit, Behar Gjoka.

Nga Instituti i Historisë në këtë sesion shkencor mori pjesë prof. dr. Muharrem Dezhgiu me kumtesën “Pjetër Budi dhe vendlindja e tij”. Ai trajtoi aspekte të ndikimit të traditave kulturore të Gurit të Bardhë, vendlindjes së Budit, në veprimtarinë fetare, kulturore e kombëtare të tij. Sipas prof. M. Dezhgiut, megjithëse Pjetër Budi ishte i lidhur ngushtë me vendlindjen e tij dhe kjo konstatohet në veprën e tij gjuhësore e letrare, ai mbeti mbështetës i projektit të tij për një lëvizje çlirimtare me shtrirje të gjerë që shkonte nga Kelmendi në Mat, Krujë, Çermenikë, nga fusha e Shkodrës në Ishëm, Durrës, Ndroq, Elbasan. Pra, Budi ishte promotor i bashkimit kombëtar në luftën e shqiptarëve për çlirim. Ky rol që luajti Budi me veprën atdhetare dhe rrethanat e dyshimta të vdekjes së tij, vlerësoi prof. M. Dezhgiu, përjetësuan Pjetër Budin si një dëshmor të luftës çlirimtare të popullit shqiptar në shek. XVII.

Rreth kumtesave u bënë diskutime me interes si, për të theksuar aspekte të veçanta të këtyre trajtesave, ashtu dhe për nevojën e thellimit të studimeve për veprën e Pjetër Budit dhe kohën e tij.

* * *